



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe nenit 65 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77 / 16 gusht 2010), të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-150 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 10 / 03 Prill 2017) dhe nenit 18 dhe nenit 136 të Ligjit 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10 / 14 maj 2026), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 qershor 2026, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR REGJISTRIN PUBLIK TË INSTITUCIONEVE TË PAGESAVE DHE INSTITUCIONEVE TË PARASË ELEKTRONIKE

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo rregullore përcakton kërkesat dhe kriteret për themelimin e regjistrit publik të institucioneve të pagesave, institucioneve të parasë elektronike dhe agjentëve të këtyre institucioneve në përputhje me nenin 18 të Ligjit 10/L-026 për shërbimet e pagesave (“Ligji për Shërbimet e Pagesave”).
2. Kjo rregullore zbatohet për institucionet e pagesave, institucionet e parasë elektronike dhe të gjithë personat dhe subjektet e tjera të përcaktuara në nenin 3 të kësaj rregulloreje, që janë të autorizuar të ofrojnë shërbime të pagesave në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shërbimet e Pagesave.

KAPITULLI II REGJISTRI PUBLIK

Neni 2 Regjistri publik

1. Banka Qendrore e Kosovës (BQK) themelon dhe mirëmban një regjistër publik që përmban të dhënat e mëposhtme:
 - 1.1. institucionet e autorizuar të pagesave dhe agjentët e tyre;
 - 1.2. institucionet e autorizuar të parasë elektronike dhe agjentët e tyre;

- 1.3. shërbimet e pagesave të përfshira në autorizimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike;
 - 1.4. ofruesit e shërbimeve të informacionit të llogarisë, që ofrojnë ekskluzivisht këtë lloj shërbimi, dhe agjentët e tyre;
 - 1.5. ofruesit e shërbimeve të përcaktuar në nën-nënparagrafët 1.11.1 dhe 1.11.2 dhe në nënparagrafin 1.12 të nenit 3 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave, duke përfshirë një përshkrim të aktivitetit të njoftuar sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje;
 - 1.6. likuidimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike që kanë zyrën e tyre qendrore në Kosovë dhe identitetin e administratorëve apo likuiduesve;
 - 1.7. listën e ofruesve të tjerë të shërbimeve të pagesave të përcaktuar në nenin 4 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave.
2. Institucionet e autorizuar të pagesave dhe institucionet e parasë elektronike regjistrohen në një listë të veçantë nga personat dhe subjektet e tjera të autorizuar për të ofruar shërbime të pagesave.
 3. Tërheqja e autorizimit sipas nenit 16 dhe tërheqja e përjashtimit sipas kushteve të nenit 24 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave regjistrohen në regjistrin publik.
 4. Informacioni i përshkruar në paragrafët e mëparshëm do të jetë i disponueshëm në publik dhe i përditësuar në mënyrë të vazhdueshme në ueb faqen e Bankës Qendrore të Kosovës.

Neni 3

Subjektet dhe personat që i nënshtrohen kërkesave për regjistrim

1. Regjistri përfshin personat fizikë ose juridikë të mëposhtëm që mund të ofrojnë shërbime të pagesave dhe/ose shërbime të parasë elektronike, siç përcaktohet në Ligjin për Shërbimet e Pagesave:
 - 1.1. “Institucionet e pagesave” siç përcaktohet në nënparagrafin 1.3 të nenit 4 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave;
 - 1.2. “Institucionet e pagesave të përjashtuara” sipas nenit 24 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave;
 - 1.3. “Ofruesit e shërbimeve të informacionit të llogarisë” sipas nenit 25 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave;
 - 1.4. “Institucionet e parasë elektronike” siç përkufizohet në nënparagrafin 1.48 të nenit 4 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave;
 - 1.5. “Institucionet e përjashtuara të parasë elektronike” sipas nenit 34 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave;
 - 1.6. “Agjentët” siç përkufizohet në nënparagrafin 1.37 të nenit 4 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave;
 - 1.7. subjektet që kanë të drejtë të ofrojnë shërbime të pagesave në Kosovë sipas nënparagrafit 1.6. të nenit 1 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave;
 - 1.8. ofruesit e shërbimeve të përjashtuar nga fusha e veprimit të Ligjit për Shërbimet e Pagesave në pajtim me nënparagrafët 1.11.1 dhe 1.11.2 dhe nënparagrafët 1.12 të nenit 3 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave.

2. Regjistri i subjekteve të përcaktuara në nënparagrafët 1.2, 1.5 dhe 1.8 të paragrafit të mëparshëm duhet të përfshijë, minimalisht, emrin, vendndodhjen e zyrës qendrore, degëve dhe agjencive, dhe një përshkrim të aktiviteteve që subjekti ofron dhe/ose është i autorizuar të ofrojë, si dhe çdo element apo informacion tjetër që do të vendoset nga BQK rast pas rasti.
3. Përshkrimi i aktiviteteve të subjekteve të përcaktuara në nënparagrafin 1.8 të paragrafit 1 të këtij neni, siç kërkohet në paragrafin 2 të këtij neni, jepet në përputhje me nenin 4 të kësaj rregulloreje.

Neni 4

Detyrimet e njoftimit

1. Ofruesit e shërbimeve që kryejnë ndonjë nga aktivitetet e përcaktuar në nënparagrafët 1.11.1 dhe 1.11.2 të nenit 3 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave, ose të dyja aktivitetet, kur vlera totale e transaksioneve të pagesave të realizuara në 12 muajt e mëparshëm tejkalon 1 milion euro, duhet të njoftojnë BQK-në në pajtim me paragrafin 2 të nenit 28 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave.
2. Në bazë të këtij njoftimi, BQK , brenda afatit të paraparë në nenin 15 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave, duhet të marrë vendim të arsyetuar, bazuar në kriteret e përcaktuar në paragrafin 1.11 të nenit 3 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave, nëse aktiviteti nuk kualifikohet si rrjet i kufizuar, dhe për këtë e informon ofruesin e shërbimit.
3. Ofruesit e shërbimeve që kryejnë një aktivitet të përcaktuar në nenin 3, nënparagrafi 1.12 i Ligjit për Shërbimet e Pagesave i dërgojnë BQK-së një njoftim që përmban një përshkrim të shërbimeve të ofruara dhe i dorëzojnë BQK-së një opinion vjetor të auditimit që konfirmon se aktiviteti është në përputhje me kufijtë e përcaktuar në nënparagrafin 1.12.
4. Përshkrimi i aktivitetit të njoftuar në përputhje me paragrafët 1 dhe 3 të këtij neni do të jetë publikisht në dispozicion në regjistrin publik të përcaktuar në këtë rregullore.

KAPITULLI III

INSTITUCIONET E PAGESAVE, INSTITUCIONET E PARASË ELEKTRONIKE DHE AGJENTËT E TYRE

Neni 5

Kërkesa për regjistrim

Institucionet e pagesave, duke përfshirë ofruesit e shërbimeve të informacionit të llogarisë, institucionet e parasë elektronike dhe agjentët e tyre, nuk do të fillojnë aktivitetin e tyre para se të regjistrohen në regjistrin e BQK-së sipas nenit 2 paragrafi 2 i kësaj rregulloreje.

Neni 6

Regjistrimi i institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike dhe agjentëve të tyre

1. Regjistrimi i institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike përfshin këto të dhëna:
 - 1.1. emrin e kompanisë dhe biznesit ose atë tregtar nëse është i ndryshëm;

- 1.2. numrin unik të identifikimit të biznesit;
- 1.3. numrin dhe datën e autorizimit të dhënë;
- 1.4. adresën e zyrës qendrore;
- 1.1. kapitalin aksionar;
- 1.5. kapitalin fillestar të paguar;
- 1.6. identitetin e aksionarëve me pjesëmarrje të kualifikuar dhe përqindjet e pjesëmarrjes në kapital;
- 1.7. identitetin e drejtorëve, personave përgjegjës për menaxhimin e institucioneve dhe firmat e auditimit;
- 1.8. adresën e degëve;
- 1.9. listën dhe datën e fillimit të aktiviteteve të lejueshme të kryera;
- 1.10. numrin dhe datën e vendimit për pezullimin e një ose disa aktiviteteve nga BQK .
- 1.11. numrin dhe datën e vendimit për tërheqjen e autorizimit;
- 1.12. numrin dhe datën e vendimit për likuidim të institucionit.
2. BQK-ja regjistron të dhënat e përcaktuara në paragrafin 1, nënparagrafët 1.1 deri në 1.9 të këtij neni, brenda 15 ditëve pune nga data e autorizimit, si dhe të dhënat për revokimin e licencës ose pezullimin e një ose disa aktiviteteve, të parashikuara në nënparagrafët 1.10 deri në 1.12 të paragrafit 1 të këtij neni, brenda 15 ditëve pune nga data e vendimit përkatës.
3. Institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike duhet të informojnë BQK-në , sapo të jenë në dijeni për ndonjë zhvillim, ndryshim apo modifikim të informacionit të përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafët 1.1 deri në 1.9 të këtij neni.
4. BQK-ja, për çdo ndryshim të të dhënave të përcaktuara në paragrafin 1, nënparagrafët 1.1 deri në 1.9 të këtij neni, të kryer nga subjekti, i përditëson këto të dhëna në regjistrin publik, brenda 15 ditëve pune nga data e njoftimit.
5. Regjistrimi i agjentëve të institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike përfshin:
 - 5.1. emrin, numrin unik të identifikimit (NUI) të biznesit dhe adresën e agjentit;
 - 5.2. identitetin e drejtorëve dhe personave përgjegjës për menaxhimin e agjentit që do të përdoret në ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe, për agjentë të ndryshëm nga ofruesit e shërbimeve të pagesave;
 - 5.3. shërbimet e pagesave të institucionit të pagesave për të cilin është mandatuar agjenti;
6. BQK-ja regjistron agjentin dhe të dhënat e përcaktuara në paragrafin 5 të këtij neni, brenda 2 muajve nga data e dorëzimit të dokumentacionit të përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 21 të Ligjit për shërbimet e pagesave, nga institucioni i pagesave dhe institucioni i parasë elektronike. Vetëm pas regjistrimit sipas këtij paragrafi, agjenti mund të fillojë ofrimin e shërbimit të pagesave dhe/ose shërbimeve të parasë elektronike.

Neni 7

Regjistrimi i ofruesve të shërbimeve të informacionit të llogarisë

1. Për ofruesit e shërbimeve të informacionit të llogarisë, regjistri duhet të përmbajë këto të dhëna:
 - 1.1. emrin, numrin unik të identifikimit (NUI) të biznesit dhe adresën e ofruesit;
 - 1.2. identitetin e drejtorit, të personave përgjegjës për administrimin e institucioneve,
 - 1.3. numrin dhe datën e vendimit të regjistrimit
 - 1.4. vendndodhjen e zyrës qendrore, degëve dhe agjencive,
 - 1.5. aktivitetet që subjekti ofron dhe/ose është i regjistruar të ofrojë,
 - 1.6. numrin dhe datën e vendimit për tërheqjen e regjistrimit ,
 - 1.7. si dhe çdo element apo informacion tjetër që do të vendoset nga BQK rast pas rasti.
2. BQK-ja regjistron ofruesin e shërbimeve të informacionit të llogarisë dhe të dhënat e përcaktuara në paragrafin 1, nënparagrafët 1.1 deri në 1.5 të këtij neni, brenda 90 ditëve nga data e pranimit të kërkesës për regjistrim, siç përcaktohet në nenin 58 të Rregullores për autorizimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike dhe për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të informacionit të llogarisë.
3. Ofruesit e shërbimeve të informacionit të llogarisë, duhet të informojnë BQK-në, posa të kenë dijeni për ndonjë zhvillim, ndryshim apo modifikim të informacionit të përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafët 1.1 deri në 1.5 të këtij neni. BQK-ja i përditëson këto të dhëna në regjistrin publik brenda 15 ditëve pune nga data e njoftimit. BQK-ja përfshin në regjistër, numrin dhe datën e vendimit për tërheqjen e regjistrimit të ofruesit të shërbimeve të informacionit të llogarisë nga regjistri publik, brenda 15 ditëve pune nga data e marrjes së këtij vendimi.
4. Regjistrimi i agentëve të ofruesve të shërbimeve të informacionit të llogarisë përfshin:
 - 4.1. emrin, numrin unik të identifikimit (NUI) të biznesit dhe adresën e agentit;
 - 4.2. identitetin e drejtorit dhe të personave përgjegjës për menaxhimin e veprimtarisë së shërbimeve të pagesave që agjenti do të kryejë në emër dhe për llogari të subjektit;
 - 4.3. shërbimet e pagesave që do të kryhen nga agjenti;
5. BQK-ja regjistron agentin dhe të dhënat e përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni, brenda 2 muajve nga data e dorëzimit të dokumentacionit të paraparë në paragrafin 2 të nenit 21 të Ligjit për shërbimet e pagesave, nga ofruesit e shërbimeve të informacionit të llogarisë. Vetëm pas regjistrimit sipas këtij paragrafi, agjenti mund të fillojë ofrimin e shërbimit të pagesave dhe/ose shërbimeve të parasë elektronike.

Neni 8

Regjistrimi i ofruesve të shërbimeve që përfitojnë nga përjashtimet

1. Për subjektet e përcaktuara në nënparagrafët 1.2, 1.5 dhe 1.8 të nenit 3 të kësaj rregulloreje, regjistri përmban:
 - 1.1. emrin, numrin unik të identifikimit (NUI) të biznesit dhe adresën e ofruesit;

- 1.2. identitetin e drejtorit dhe të personave përgjegjës për menaxhimin e institucioneve,
 - 1.3. numrin dhe datën e vendimit të regjistrimit;
 - 1.4. vendndodhjen e zyrës qendrore, degëve dhe agjencive,
 - 1.5. veprimtaritë e kryera nga subjekti;
 - 1.6. numrin dhe datën e vendimit për çregjistrimin e subjektit nga regjistri publik;
 - 1.7. si dhe çdo element apo informacion tjetër që do të vendoset nga BQK rast pas rasti.
2. BQK-ja i regjistron të dhënat e përcaktuara në paragrafin 1, nënparagrafët 1.1 deri 1.5 të këtij neni, brenda 15 ditëve pune nga data e vendimit për regjistrim në regjistrin publik.
 3. Ofruesit e shërbimeve që përfitojnë nga përjashtimet, informojnë BQK-në, sapo të kenë dijeni për ndonjë zhvillim, ndryshim apo modifikim të informacionit të përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafët 1.1 deri në 1.5 të këtij neni. BQK-ja i përditëson këto të dhëna brenda 15 ditëve pune nga data e njoftimit për çdo ndryshim që mund të ndodhë në të dhënat e mësipërme.
 4. BQK-ja përfshin në regjistër, numrin dhe datën e vendimit, për çregjistrimin e subjekteve nga paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 i këtij neni, brenda 15 ditëve pune nga data e marrjes së këtij vendimi.

Neni 9

Refuzimi i regjistrimit

1. Përveç çdo arsyeje tjetër të parashikuar nga Ligji për Shërbimet e Pagesave ose kjo rregullore, regjistrimi refuzohet në rastet e mëposhtme:
 - 1.1. nëse elementi që do të regjistrohet nuk mbështetet nga dokumentet e paraqitura;
 - 1.2. nëse elementi i treguar në dokument është tashmë i regjistruar ose nuk i nënshtrohet regjistrimit;
 - 1.3. në mungesë të ndonjë autorizimi të kërkuar me ligj;
 - 1.4. nëse nuliteti i faktit është i dukshëm;
 - 1.5. nëse vërtetohet se nuk plotësohet ndonjë nga kushtet për autorizimin e nevojshëm për krijimin e institucionit të pagesave ose institucionit të parasë elektronike, ose për ushtrimin e veprimtarisë së ofrimit të shërbimeve të pagesave ose të emetimit, shpërndarjes dhe shlyerjes së parasë elektronike.
2. Çdo aplikim për regjistrim i paraqitur nga një person fizik ose juridik që ofron vetëm shërbime të informacionit të llogarisë do të refuzohet në rastet e mëposhtme:
 - 2.1. nëse aplikacioni është dorëzuar pa ndonjë nga elementet e përcaktuara në nenin 12, paragrafi 1, nënparagrafët 1.1, 1.2, 1.5, 1.6, 1.7, 1.8, 1.10, 1.12, 1.14, 1.16 dhe 1.17 të Ligjit për shërbimet e pagesave;
 - 2.2. nëse nuk ka dëshmi për lidhjen e një sigurimi për përgjegjësinë profesionale ose garanci tjetër të krahasueshme siç përcaktohet në nenin 8 paragrafi 3 të Ligjit për shërbimet e pagesave.

KAPITULLI IV

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 10

Zbatimi, masat përmirësuese dhe ndëshkimet

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje do t'i nënshtrohet masave korrigjuese dhe/apo ndëshkuese administrative, të përcaktuara në nenin 67 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-150 dhe nenin 125 të Ligjit 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë nga data e miratimit të saj.

Dr.sc. Bashkim Nurboja

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës